

**REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA**

Në çështjen juridike të :**AC-I-22-0098-A0001***Paditësi***A Zh**, me përfaqësues sipas autorizimit, avokatin B I, Prishtinë**Kundër:***E paditura/Ankuese***N.SH. “Enti i Projektimit Ening”** (në likuidim), me përfaqësuese **Agjencia Kosovare e Privatizimit**, rr. “Dritan Hoxha”, nr.55, Lakrishte, Prishtinë.

Kolegji i Apelit i Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (DHPGJS), i përbërë nga Mr.sc. Sahit Sylejmani, gjyqtar kryesues, Ilmi Bajrami dhe Shkelzen Sylaj, gjyqtarë, duke vendosur lidhur me ankesën e të paditurës të paraqitur kundër Aktgjykimit të shkallës së parë të DHPGJS-së, C-IV-15-0072, të datës 20 janar 2022, pas seancës vendimmarrëse të mbajtur më 24 janar 2024, lëshon këtë:

A K T G J Y K I M

1. Ankesa e të paditurës është e bazuar.
2. Ndryshohet Aktgjykimi i shkallës së parë të DHPGJS-së, C-IV-15-0072, i datës 20 janar 2022.
3. Vërtetohet vendimi i Autoritetit të Likuidimit me nr. PEJ102-0015 i datës 30 dhjetor 2014.
4. Nuk caktohen taksa gjyqësore për procedurën ankimore.

Rrethanat procedurale dhe faktike

Me datë 28 janar 2015, paditësi kishte parashtruar një ankesë kundër vendimit të Autoritetit të Likuidimit me nr. PEJ102-0015 të datës 30 dhjetor 2014, me të cilin vendim kërkesa e paditësit për kompensim për paga të papaguara për periudhën nga 1 janar 2010 deri më 1 nëntor 2014 në shumën prej 19,140.00 euro nga N.SH “Enti i Projektimit Ening”, ishte refuzuar si e pavlefshme, pasi që kërkesa e parashtruesit në bazë të nenit 608 të Ligjit për Punën e Bashkuar ishte parashkruar.

Në ankesë theksohet se vendimi i ankimuar është përfshirë në shkelje esenciale të dispozitave procedurale, konstatim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike si dhe zbatim të gabuar të së drejtës materiale, në të cilën i ishte propozuar gjykatës që të miratohet në tërësi ankesa e ankuesit si e bazuar dhe të obligohet e paditura që ankuesit t’ia bëjë kompensimin e pagave të papaguara në shumën prej 17,400.00 euro dhe për periudhën e lartcekur, gjithsej për 58 muaj me pagë mujore 300 euro bruto duke përfshirë kamatën e kalkuluar sipas nenit 37.7 të Shtojcës së Ligjit të AKP-së në shumën prej 1,740.00 euro si dhe shpenzimet e përfaqësimit në shumën prej 104.00 euro.

Ankesës i kishte bashkëngjitur këto prova: autorizimin për përfaqësim, kopjen e letërnjoftimit, kopjen e librezës së punës, njoftimin për fillimin e likuidimit të ndërmarrjes (për të gjithë kreditorët dhe pronarët e ndërmarrjes), formularin për parashtrimin e kërkesës jo pronësore në likuidim, vendimin e Autoritetit të Likuidimit me nr. PEJ102-0015 i datës 30 dhjetor 2014.

Me datë 26 qershor 2020, AKP-ja kishte paraqitur mbrojtjen e saj në të cilën thekson se parashtruesi nuk ka treguar se cili nen i Ligjit për AKP-në është shkelur nga Autoriteti i Likuidimit në marrjen e vendimit dhe në këtë mënyrë ka shkelur nenin 74.2 të Ligjit 06/L-086 i cili parashikon që ankesat e dorëzuara në DHPGJS kundër vendimeve të Autoritetit të Likuidimit duhet të bazohen në pretendimin se procesi i likuidimit nuk është kryer në përputhje me Ligjin për AKP-në. Tutje, pala kundërshtare thekson se pretendimet e parashtruesit janë të parashkruara pasi që nuk ka asnjë provë përpara Autoritetit të Likuidimit që parashtruesi e ka dorëzuar këtë kërkesë para ndonjë gjykate apo organi tjetër kompetent brenda tre vjetëve nga momenti kur N.SH pretendohet të mos ketë përmbushur obligimet e saj ndaj parashtruesit që rrjedhin nga marrëdhënia e punësimit. Gjithashtu, pala kundërshtare rikujton se natyra e lëndës

është përsëritëse, pra ka një jurisprudencë të konfirmuar disa herë të DHPGJS-së e cila trajton këto lloj pretendimesh. Zbatimi i saktë i nenit 608 të Ligjit për Punën e Bashkuar është konfirmuar në më shumë se një rast nga DHPGJS (Aktgjykimet e Kolegjit të Apelit AC-I-15-0029 të datës 8 qershor 2017, AC-I-15-0051 të datës 27 korrik 2017, AC-I-16-0187 të datës 23 shkurt 2017, etj). Andaj, kishte propozuar që ankesa e paditësit të refuzohet si e pabazuar apo e papranueshme dhe të vërtetohet vendimi i ankimuar i Autoritetit të Likuidimit. Mbrojtjes i kishte bashkëngjitur vendimin për emërimin e anëtarëve të Autoritetit të Likuidimit.

Me datë 11 shkurt 2021, paditësi kishte paraqitur përgjigje në mbrojtje të AKP-së në të cilën theksonte se AL në rastin konkret nuk e ka vërtetuar gjendjen faktike fare dhe ka bërë zbatim të gabuar të së drejtës materiale, përkatësisht nenit 608 të Ligjit për Punën e Bashkuar. Tutje, theksonte se e paditura ishte e obliguar që për çdo kontratë të njoftonte punëtorin për ndërprerjen e kësaj marrëdhënie duke lëshuar dokumentin zyrtar Letër Pezullimin. Tutje, paditësi kishte përsëritur pretendimet e tij si në ankesën e tij ndaj vendimit të AL-së dhe i propozon gjykatës që të miratoj kërkesëpadinë e paditësit. Përgjigjes i kishte bashkëngjitur: kopjen e librezës së punës, një vërtetim për përvojën e punës dhe të ardhurat personale të realizuara, një ekstrakt mbi të ardhurat personale për paditësin, njoftimin për të gjithë kreditorët dhe pronarët e ndërmarrjes për fillimin e procedurës së likuidimit dhe afatin e parashtrimit të kërkesave, formularin për parashtrimin e kërkesës jo-pronësore në likuidim, vendimin e Autoritetit të Likuidimit me nr. PRN102-0015 të datës 30 dhjetor 2014 dhe qarkullimin e llogarisë bankare.

Me datë 31 mars 2021, AKP-ja kishte paraqitur kundërpërgjigje në përgjigjen e paditësit në të cilën i përsëritë pretendimet e saj si në mbrojtje dhe i propozon gjykatës që të refuzoj parashtrësën e paditësit dhe të vërtetoj vendimin e Autoritetit të Likuidimit.

Me datë 20 prill 2021, gjykata kishte lëshuar një urdhër për AKP-në nga e cila kërkon që të plotësoj kundërpërgjigjen ndaj përgjigjes së paditësit, për arsye se konsideron se nuk është e kuptueshme si e tillë është e përgjithësuar dhe e pa qartë.

Me datë 19 maj 2021, e paditura kishte paraqitur përgjigje ndaj urdhrin të gjykatës në të cilin thekson se në lidhje me pretendimet e parashtruesit të kërkesës për paga, AL konsideron se aplikimi i dispozitave me të cilat kërkesa është konsideruar e parashkruar është krejtësisht e

drejtë dhe e bazuar në ligj. Kërkesa e paditësit është dashur të paraqitet më së voni me datë 1 janar 2013. Sa i përket pyetjes se në cilën datë ndërmarrja ka pasur funksionimin ekonomik, AL thekson se nuk posedon informatë të tillë sepse ndërmarrja nuk ka dorëzuar asnjëherë pasqyra financiare tek AKP-ja dhe se në nuk mund të ofrojmë informata të tilla kur ndërmarrja ka hyrë në likuidim dhe për këtë i gjeni dokumentet e bashkëngjitura për likuidimin e ndërmarrjes “Ening”.

Me datë 23 korrik 2021, paditësi kishte paraqitur përgjigje në urdhrin e gjykatës të datës 9 korrik 2021, në të cilën përveç që përsërite pretendimet si në ankesë e përgjigje në mbrojtje, i njëjti kishte angazhuar ekspertin financiar Prof. A B lidhur me përpilimin e ekspertizës financiare lidhur me kërkesën kreditore, objekt shqyrtimi në rastin konkret. Kësaj përgjigje i kishte bashkëngjitur ekspertizën e ekspertit në fjalë.

Me datë 26 gusht 2021, e paditura paraqet kundërpërgjigje në përgjigjen e paditësit, në të cilën propozon që të refuzohet përgjigja e paditësit si e pabazuar dhe të vërtetohet vendimi i ankimuar i AL-së. Përgjigjes i kishte bashkëngjitur vendimin e ankimuar të AL-së.

Me datë 20 janar 2022, shkalla e parë e DHPGJS-së me Aktgjykimin C-IV-15-0072 kishte aprovuar si të bazuar pjesërisht ankesën e paditësit, duke obliguar të paditurën që paditësit për pagat e papaguara për periudhën nga 1 nëntor 2011 deri më 15 shtator 2014 t’ia paguaj shumën bruto prej 10,350.00 euro e në të cilën shumë është llogaritur kontributi për pension në trust 1,035.00 euro, tatimi në pagë 329.00 euro, duke mbetur paga neto 9,504.00 euro me kamatë 10% të shumës themelore si dhe shpenzimet e procedurës në shumën prej 312.00 euro, ndërsa pjesën tjetër të kërkesës për pagat e papaguara mbi shumën e gjykuar në paragrafin 1 e refuzon si të pabazuar. Në arsyetimin e këtij Aktgjykimi theksohet se gjykata kishte shqyrtuar ë gjitha provat që i kanë ofruar palët ndërgjyqëse dhe kishte konstatuar se nuk është kontestues fakti se paditësi ishte punëtor i të paditurës deri kur ka filluar procedura e likuidimit me vendimin e Bordit të AKP-së që nga data 15 shtator 2014. Paditësi sikundër edhe e paditura nuk kanë dorëzuar asnjë provë apo dëshmi që në momentin e fillimit të procedurës së likuidimit të ndërmarrjes të jetë pranuar ose lëshuar një njoftim për ndërprerje të marrëdhënies së punës. Paditësi sikundër edhe e paditura nuk kanë dorëzuar asnjë provë ose dëshmi me të cilin vërtetohet fakti se paditësi gjatë periudhës për të cilën kërkohen pagat e papaguara të ketë kryer punë dhe detyra të punës sipas kontratës së punës e për të cilën nuk i janë paguar pagat. Sipas

ekspertizës financiare të llogaritur nga eksperti A B, pagat nga data 1 nëntor 2011 deri më 1 nëntor 2014 të arritura për pagesë janë paga bruto në shumën prej 11,10.00 euro, kontributi pensional në shumën prej 1,100.00 euro, tatimi në pagë në shumën prej 355.00 euro ose paga neto në shumën prej 10,190.00 euro. Sipas llogaritjes tjetër të ekspertit financiar, të datës 14 dhjetor 2021, që përfshin periudhën prej 1 nëntor 2011 deri më datë 15 shtator 2014, kur në këtë datë N.SH ka hyrë në procedurë të likuidimit, paga bruto është llogaritur në shumën 10,350.00 euro, kontributi pensional në shumën prej 1,035.00 euro dhe tatimi në pagë në shumën prej 329.00 euro ose paga neto në shumën prej 9.504.00 euro. Mirëpo meqenëse procedura e likuidimit ka filluar me datë 15 shtator 2014 nënkupton se sipas ligjit paditësit i ka përfunduar punësimi me datë 15 shtator 2014 dhe pas kësaj date ai nuk ka bazë juridike të kërkoj pagat e papaguara për periudhën nga 15 shtator 2014 deri më 1 nëntor 2014. Gjykata pjesën tjetër të kërkesës mbi shumën e pagës bruto siç është gjykuar e kishte refuzuar si të pabazuar për faktin se në këtë pjesë është kërkuar edhe paga pas datës 15 shtator 2014 e kjo datë është datë kur ka filluar procedura e likuidimit dhe që sipas ligjit merret se në këtë datë edhe ka përfunduar marrëdhënia e punës së paditësit me të paditurën, gjë që paditësit i mungon baza juridike për të kërkuar këto paga për periudhën nga 15 shtator 2014 deri më 1 nëntor 2014.

Me datë 22 shkurt 2022, AKP-ja kishte paraqitur ankesë kundër Aktgjykimit C-IV-15-0072 të datës 20 mars 2022, duke i propozuar Kolegjit të Apelit që të ndryshoj Aktgjykimin e ankimuar ashtu që të refuzoj ankesën e paditësit të ushtruar kundër vendimit të AL-së. Në ankesë theksohet se Autoriteti i Likuidimit ka vërejtur se gjykata gjatë shqyrtimit të çështjes ka ngatërruar dy çështje krejtësisht të ndryshme nga njëra tjetra. AL nuk e ka mohuar faktin se ndërprerja e marrëdhënies së punës parashtruesit i është ndërprerë për shkak të privatizimit, mirëpo ka sqaruar shumë qartë se janë dy afate të ndryshme të parashkrimit që AL është i obliguar t'i pranoj dhe përmes të cilave AL aplikon në mënyrë të drejtë ligjin. Afati i parë ka të bëjë me afatin për parashtrim të kërkesave ndërsa i dyti ka të bëjë me natyrën e të drejtës që parashtruesi ka kërkuar të zbatohet në kërkesë. Afatet e lartcekura theksohet se janë të ndara dhe të dallueshme dhe një kreditor duhet t'i përmbushë të dyja afatet në mënyrë që t'i pranohet kërkesa. Sa i përket konstatimit të gjykatës se *“Njoftimi për ndërprerje të marrëdhënies së punës”* ndërprente parashkrimin, pala kundërshtare sqaron gjykatën se njoftimi të cilit i referohet parashtruesi e informon atë se ka të drejtë të parashtrtoj kërkesën pranë AKP-së dhe se kërkesa të tilla do të shqyrtohen në procedurë të likuidimit. Andaj fton DHPGJS-në që të

lëshohet edhe njëherë në shqyrtim të çështjes në fjalë dhe të konsideroj argumentet e Autoritetit të Likuidimit që kanë të bëjnë me kufizimet e të drejtave të parashtruesve, e që këto kufizime AL është i obliguar t'i zbatoj ex officio. AL rithekson edhe njëherë se parashtruesi nuk saktëson se cili nen i Ligjit 04/L-034 është shkelur nga Autoriteti i Likuidimit në marrjen e vendimit dhe në këtë mënyrë ka shkelur nenin 70.2 të shtojcës së Ligjit 04/L-033 i cili parashikon se *“ankesa duhet të bazohet ne pretendimin se procesi i likuidimit nuk është kryer në përputhje me Ligjin për AKP-në”*. Andaj, duke pasur parasysh këto që u thanë i kishte propozuar Kolegjit të Apelit si më lartë. Ankesës i kishte bashkëngjitur Aktgjykimin e ankimuar.

Me datë 20 shtator 2023, paditësi kishte paraqitur përgjigje në ankesën e të paditurës në të cilën kishte propozuar që ankesa e të paditurës të refuzohet si e pabazuar, të vërtetohet Aktgjykimi i ankimuar dhe të detyrohet e paditura të bëjë kompensimin e shpenzimeve të përfaqësimit në bazë të Tarifës së OAK.

Arsyetimi ligjor:

Ankesa e të paditurës është e bazuar.

Në bazë të nenit 69.1 të Ligjit të Republikës së Kosovës nr. 06/L-086 mbi Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet lidhur me Agjencinë Kosovare të Privatizimit, Kolegji i Apelit vendos që të heq dorë nga pjesa gojore e procedurës.

Merita e ankesës dhe vlerësimi i Kolegjit të Apelit

Aktgjykimi i ankimuar shkallës së parë të DHPGJS-së nuk është i saktë në rezultat dhe në arsyetimin ligjor, andaj duhet të ndryshohet .

Kolegji i Apelit vëren se kërkesa e paditësit për kompensimin për paga të papaguara për periudhën nga data 1 janar 2010 deri më 1 nëntor 2014 në shumën prej 19,140.00 euro, ishte refuzuar si e pavlefshme me arsyetimin se afati kohor kur paditësja kishte parashtruar kërkesën e saj për realizimin e së drejtës së saj të pretenduar, e njëjta ishte parashkruar.

Paditësi në ankesën e saj të paraqitur kundër vendimit të Autoritetit të Likuidimit me nr. PEJ102-0015 të datës 30 dhjetor 2014, i kishte bashkëngjitur këto prova: kopjen e librezës së

punës, një vërtetim për përvojën e punës dhe të ardhurat personale të realizuara, një ekstrakt mbi të ardhurat personale për paditësin, njoftimin për të gjithë kreditorët dhe pronarët e ndërmarrjes për fillimin e procedurës së likuidimit dhe afatin e parashtrimit të kërkesave, formularin për parashtrimin e kërkesës jo-pronësore në likuidim, vendimin e Autoritetit të Likuidimit me nr. PRN102-0015 të datës 30 dhjetor 2014 dhe qarkullimin e llogarisë bankare si dhe ekspertizën financiare të ekspertit financiar Prof. A B lidhur me kërkesën në fjalë.

Shkalla e parë e DHPGJS, pas shqyrtimit të provave dhe shkresave të lëndës, kishte nxjerrë Aktgjykim me të cilin i kishte njohur paditësit të drejtën në kompensim për pagat e papaguara për periudhën nga 1 nëntor 2011 deri më 15 shtator 2014 në shumën bruto prej 10,350.00 euro, me pagë neto 9,504.00 euro si dhe shpenzimet e procedurës në shumën prej 312.00 euro. Ndërsa pjesën e mbetur të kërkesës e kishte refuzuar si të pabazuar.

Kolegji i Apelit në rastin konkret vlerëson se shkalla e parë e DHPGJS-së nuk kishte vepruar drejtë me rastin e marrjes së Aktgjykimit, ndërsa konsideron se ankesa e të paditurës është e bazuar.

Barra e provës sipas nenit 42.2 të Ligjit të DHPGJS për të vërtetuar këtë fakt bie mbi paditësin. Paditësi e ka sjellë në gjykatë: vendimin e ankimuar të Autoritetit të Likuidimit, autorizimin për përfaqësim ekspertizën financiare, qarkullimin e llogarisë bankare dhe asnjë dokument tjetër që do të vërtetonte se me ndonjë veprim të AKP-së, atij i është ndërprerë marrëdhënia e punës.

Kolegji i Apelit konsideron se provat e parashtruar në Gjykatë nga paditësi nuk janë të mjaftueshme me të cilat do të mund të krijonin një argument të mjaftueshme ligjore sipas së cilës mund të aprovohej kërkesa e tij.

Prandaj nga këto arsye, Kolegji i Apelit vlerëson se Aktgjykimi i ankimuar nuk ishte i saktë në rezultat dhe në arsyetimin ligjor, prandaj paditësi në mungesë të provave të cilat nuk i ka sjellë në Gjykatë, ai nuk ka të drejtë kompensimi për paga të pa paguara, bazuar në nenin 40.1.6.2 të Shtojcës së Ligjit të AKP-së nr. 04/L-034.

Gjithashtu sa i përket pretendimeve ankimore të së paditurës në ankesën e saj të paraqitur në shkallë të dytë, Kolegji i Apelit vlerëson se sipas Nenit 42.2 i Ligjit për DHPGJS, *“Pala që pretendon një fakt apo ngjarje e ka barrën e dëshmisë për të vërtetuar faktin apo ngjarjen e*

pretenduar”. E paditura ka paraqitur fakte dhe argument me të cilin do të dëshmonte të kundërtën e asaj që ka pretenduar paditësi.

Sipas nenit 11 të Ligjit për DHPGJS-në, pala e pasuksesshme duhet t’i paguaj shpenzimet procedurale, përfshirë taksat gjyqësore të palës tjetër. Ankuesi në këtë çështje është palë e pasuksesshme, prandaj shpenzimet gjyqësore janë në barrë të tij.

Nga arsyet e cekura më lartë, ankesa e të paditurës aprovohet si e bazuar ndryshohet Aktgjykimi i ankimuar i shkallës së parë të DHPGJS-së dhe vërtetohet Vendimi i Autoritetit të Likuidimit nr. PEJ102-0015 të datës 30 dhjetor 2014 si i drejtë dhe i bazuar në ligj.

Nga se u tha më sipër në bazë të nenit 9.10 të LDHP-së është vendosur si në dispozitiv.

Taksat gjyqësore

Ankuesja tashmë e ka paguar taksën gjyqësore për procedurën ankimore, andaj nuk do të caktohen taksa shtesë.

U vendos nga Kolegji i Apelit i DHPGJS-së më 24 janar 2024.

Mr.sc. Sahit Sylejmani, Gjyqtar Kryesues
